



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPLANIT
OPŠTINA LIPLAN
MUNICIPALITY OF LIPLAN

Nr. 01-020/01-54597
Datë 22-09-2023

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 të datës 4 qershor 2008 , nenit 9 pika 1 të rregullores MF – NR. 02/2013- për menaxhimin e pasurisë jofinanciare në organizatat buxhetore si dhe neneve 40 dhe 41 të statutit të Komunës së Lipjanit 1 Nr. 110-623 i datës 26.09.2008 Kryetari i Komunës, merr këtë:

AKTVENDIM PËR FORMIMIN E KOMISIONIT

Për vlerësimin e aseteve (kafshë) pronë e ekonomisë shkollore SHMP “Adem Gllavica”
Lipjan:

1. Ismet Regjepi – kryetar
2. Feti Krasniqi- anëtar
3. Brahim Duriqi- anëtar

Detyrë dhe e drejtë e komisionit është:

Vlerëson asetet (gjedhe) për të cilat shkolla ka bërë kërkesë për vlerësimin në mënyrë që të mund të shiten.

Komisioni është i obliguar që të vlerësojë secilën kafshë një nga një dhe të caktojë çmimin minimal që mund të shitet.

Komisioni do të bashkëpunojë me koordinatorin e ekonomisë së shkollës se cilat kafshë janë për shitje dhe ka nevojë për vlerësim.

Komisioni do të hartoj raport për gjendjen e kafshëve që do të dalin në ankand me çmimin minimal për to.

Komisioni është i obliguar që vlerësimin ta kryej brenda ditës së marrjes së këtij Aktvendimi.

Aktvendimi i dërgohet

- Anëtareve të komisionit,
- Arkiv-ës
- Drejtorisë së Arsimit

Kryetari i komunës

z. Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 6 të Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15Nr.670/01-21260 të datës 26.04.2022, Kryetari i Komunes nxjerr:

VENDIM

PËR CAKTIMIN E NUMRIT TË BURSIVE DHE SHUMËS FINANCIARE PËR NJË BURSË PËR STUDENTË PËR VITIN AKADEMIK-SHKOLLOR 2023/2024

Neni 1

I Me këtë Vendim CAKTOHET që për vitin akademik 2023/2024 të ndahen 170 (njëqind e shtatëdhjetë dhjetë) bursa dhe shuma financiare për një bursë do të jetë 500 € (pesëqind) euro.

Neni 2

OBLIGOHET, Drejtorati për Arsim që menjëherë pas pranimit të këtij Vendimi të përgadisë Thirrjen publike për aplikim, konform kriterëve të përcaktuara me dispozitat e Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15Nr.670/01-21260 të datës 26.04.2022 dhe Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e bursave për student të Komunës së Lipjanit Nr.15-670/01-22594 të dates 28.04.2023 dhe të njëjtën ta publikojë në faqen zyrtare të Komunës, në njërën nga gazetatat ditore me tirazh të madh dhe në tabelën e shpalljeve të Kuvendit të Komunës.

Neni 3

Shuma e cekur nga neni 1 i këtij Vendimi do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit, kategoria e subvencioneve në xhirollogaritë personale të secilit përfitues të zgjedhur.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset Drejtorati për Arsim.

1Nr. 670/01-52871
Lipjan, më 14.09.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E PERSONAVE PËRGJEGJËS PËR PROJEKTIN E BUJQËSISË ME ORGANIZATËN ISLAMIC RELIEF KOSOVA

Neni 1

Caktimi i Personave Përgjegjës

Me këtë Vendim, **Merita Zeqiri**, Zyrtare në Drejtoratin për Infrastrukturë dhe **Fatbardha Shurdhiqi** Zyrtare në Drejtoratin për Infrastrukturë, **CAKTOHEN** – Persona përgjegjës për projektin e Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari dhe Organizatës “Islamic Relief Kosova” sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit Nr.1-413/01-44206 të datës 17.08.2023 e lidhur në mesë të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës “Islamic Relief Kosova”

Neni 2

Detyrat Personave Përgjegjës

Personat përgjegjës janë të obliguar të bashkëpunojnë me Organizatën “Islamic Relief Kosova” për të gjitha procedurat për zbatimin e projektit të Marrëveshjes së bashkëpunimit Nr.1-413/01-44206 të datës 17.08.2023 e lidhur në mesë të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës “Islamic Relief Kosova” si dhe të bashkëpunojnë për procedurat e vlerësimit të aplikacioneve të fermerëve të Komunës së Lipjanit sipas thirrjes publike për aplikim Nr.12-320/01-45671 të datës 24.08.2023 për aplikacionet si në vijim: Serra me sipërfaqe 100m² dhe Motokultivator.

Neni 3

Hyrje në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohen Zyrtaret Përgjegjëse, Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari dhe Organizata “Islamic Relief Kosova”

1Nr. 112/02-51890
Lipjan, më 12.09.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, nenit 23 të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E ZYRTARIT PËRGJEGJËS PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË KONTRATAVE TË KLUBEVE SPORTIVE PËRFITUESE TË SUBVENCIONEVE PËR VITIN 2023

Neni 1

Me këtë Vendim, **Fadil Krasniqi**, Zyrtar në Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport, **CAKTOHET** Zyrtar përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kontratave të klubeve sportive përfituese të subvencioneve për vitin 2023.

Zyrtari përgjegjës do të bëjë monitorimin e zbatimit të kontratave të klubeve sportive si vijon :

Nr.	Emërtimi i klubit sportiv
1.	KF "Ulpiana-1926" - Lipjan
2.	KF "Arbëria" - Dobrajë e Madhe
3.	KV "Ulpiana 1992" - Lipjan
4.	KV "Ulpiana" meshkujt - Lipjan
5.	KA "Blinaja"
6.	KV "Skenderbeu"
7.	KF "Minatori" - Magure
8.	Shoqata e Pedagogëve të sportit shkollor
9.	Klubi Basketbollit "Lipjani"
10.	Klubi i Shahit "Ulpiana"
11.	Klubi i Shahit "Ced Elita"

Neni 2

Zyrtari përgjegjës është i obliguar të bëjë monitorimin e zbatimit të Kontratave të klubeve të cekura konform dispozitave të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, obligohet zyrtari përgjegjës që të kërkon nga Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport paisjen me nga një kopje të kontratave të cekura në nenin 1.

Neni 3


Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Fadil Krasniqi zyrtar përgjegjës dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

1Nr. 112/02-54541

Lipjan, më 22.09.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 19 të Rregullores nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR INVENTARIZIMIN E PASURISË JOFINANCIARE TË
KOMUNËS

I. Për inventarizimin e pasurive jofinanciare të Komunës formoj Komisionin në këtë përbërje:

1. Burim Gashi, Drejtorati për Administratë, Kryesues
2. Islam Kalessi, Zyra e Kryetarit të Komunës, anëtar
3. Ramiz Gashi, DKRS, anëtar
4. Liridon Duhlaku, SHMP "Adem Gllavica" anëtar
5. Ragip Hasani, QKMF, anëtar

II. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni në pajtim me Rregulloren nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore, ka për detyrë dhe përgjegjësi si vijon :

1. Të inventarizoj të gjithë pasurinë jofinanciare që është në pronësi dhe kontroll të Komunës,
2. Të bëj verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes të pasurisë jofinanciare ,
3. Të bëj krahasimin e gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jofinanciare,
4. Të identifikojë pasurinë që nuk ka vlerë të bartur,
5. Të identifikojë pasuritë e dëmtuara dhe jashtë përdorimit

III. Përgatitja e raportit për kryerjen e inventarizimit

Komisioni pas kryerjes së inventarizimit duhet të hartoj dhe prezentoj raportin për inventarizimin e pasurisë jofinanciare më së largu deri me datë 15 Janar 2024.

IV. Me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

V. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe do të publikohet në Webfaqen e Komunës .

INr. 020/04-52870
Lipjan, më 14.09.2023

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 9 dhe 21 të Rregullores MF-NR-04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE TË KLUBEVE
SPORTIVE DHE OJQ- VE PËR NDARJE TË SUBVENCIONEVE

Neni 1

Formimi i Komisionit dhe përbërja

Me këtë Vendim, formohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave të klubeve sportive dhe OJQ-ve të ndryshme të cilat aplikojnë sipas Thirrjeve publike për aplikim të shpallura nga Komuna e Lipjanit për relizimin e projekteve të ndryshme në interes të Komunës, në këtë përbërje:

1. Vlora Krasniqi, Sektori për përfaqësim dhe përfaqësim dhe çështje ligjore , Kryesuese
2. Mergim Oruqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
3. Gafurr Hetemi, Sektori pronësor juridik, anëtar
4. Shkëlqesa Miftari, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, anëtare rezervë

Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë dhe mandati Komisionit

Komisioni i ankesave ka mandat të shqyrtoj ankesat ndaj vendimeve për moskualifikim si rezultat i mospërmbushjes së kriterëve procedurale të kriterëve procedurale të parapara me nenet 10 dhe 11 të Rregullores MF-NR-04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve , si dhe ankesat ndaj vendimeve përfundimtare në procesin e përzgjedhjes së përfituesve të mbështetjes financiare.

Komisioni i ankesave vendos lidhur me ankesën në afat prej pesë (5) ditësh nga dita e pranimin të saj.

Komisioni i ankesave nxjerr Vendim për të pranuar ose refuzuar ankesën.

Vendimi i Komisionit të ankesave është përfundimtar në procedurë administrative.

Vendimi i dërgohet parashtruesit të ankesës dhe Komisionit vlerësues.

Komisioni i ankesave mban procesverbal për të gjithë procesin e trajtimit të ankesave dhe vendimarrjes.

Komisioni ka mandat 2 vjeçar.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës ndërsa me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Kryesuesia dhe anëtarët e Komisionit.

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave të klubeve sportive dhe OJQ-ve për ndarje të subvencioneve 1Nr.020/04-51302 i datës 11.09.2023.

1Nr. 020/04-52866

Lipjan, më 14.09.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

Neni 1
Përbërja

Me këtë Vendim formohet Komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve (klubeve sportive, shoqatave sportive paralimpik) në Komunën e Lipjanit që kanë aplikuar sipas thirrjes publike Nr.5-453/01-41785 të datës 09.08.2023, në përbërje si vijon:

1. Bekim Zaskoku, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesues
2. Albulena Gashi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
3. Laureta Ahmeti, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare
4. Antigona Hyseni, nga OJQ-të, anëtare
5. Florim Budakova, nga shoqëria civile në cilësinë e ekspertit, anëtar
6. Mexhide Zejna-Gashi, Drejtorati për Arsim, anëtare rezerv

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve (klubeve sportive, shoqatave sportive paralimpik) në Komunën e Lipjanit që kanë aplikuar sipas thirrjes publike Nr.5-453/01-41785 të datës 09.08.2023, të shpallur nga Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport, Komisioni do t'i kryen detyrat konform dispozitave të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/04-49518
Lipjan, më 06.09.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008 , nenit 15 të Udhëzimit Administrativ (MPL) nr. 03/2020 për transparencë në Komuna, nenit 16 të Rregullores për transparencë në Komunën e Lipjanit 15Nr.353-35739 të datës 30.06.2021 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR HARTIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR
TRANSPARENÇË

Neni 1

Përbërja

Formohet Komisioni për hartimin e planit të veprimit për transparencë, (në vazhdim të tekstit Komisioni) në përbërje si vijon:

1. Bukurije Zejnullahu-Jashari, Shefe e Sektorit për Mardhënie me Publikun, Kryesuese,
2. Burim Gashi, Shef i Sektorit për Administratë të Përgjithshëm, anëtar
3. Valdete Muji, Zyrtare Ligjore, anëtare
4. Qendresa Jashanica-Dërmaku, Zyrtare për Informim, anëtare
5. Linda Shahini, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim, anëtare

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni ka për detyrë që të hartoj Planin e veprimit për transparencë në Komunë duke u bazuar në dispozitat ligjore përkatëse në fuqi komisioni duhet të përfundoj punën më së largu deri më datë 01.10.2023.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

INr. 020/04-48487
Lipjan, më 04.09.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 9 dhe 21 të Rregullores MF-NR-04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE TË KLUBEVE
SPORTIVE DHE OJQ- VE PËR NDARJE TË SUBVENCIONEVE

Neni 1

Formimi i Komisionit dhe përbërja

Me këtë Vendim, formohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave të klubeve sportive dhe OJQ-ve të ndryshme të cilat aplikojnë sipas Thirrjeve publike për aplikim të shpallura nga Komuna e Lipjanit për relizimin e projekteve të ndyshme në interes të Komunës, në këtë përbërje:

1. Shahadije Ibrahim, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, , Kryesuese
2. Mergim Oruqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
3. Shkëlqesa Miftari, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, anëtare
4. Qëndresa Jashanica, Zyra e Kryetarit të Komunës, anëtare rezervë

Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë dhe mandati Komisionit

Komisioni i ankesave ka mandat të shqyrtoj ankesat ndaj vendimeve për moskualifikim si rezultat i mospërmbushjes së kriterëve procedurale të kriterëve procedurale të parapara me nenet 10 dhe 11 të Rregullores MF-NR-04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve , si dhe ankesat ndaj vendimeve përfundimtare në procesin e përzgjedhjes së përfituesve të mbështetjes financiare.

Komisioni i ankesave vendos lidhur me ankesën në afat prej pesë (5) ditësh nga dita e pranimit të saj.

Komisioni i ankesave nxjerr Vendim për të pranuar ose refuzuar ankesën.

Vendimi i Komisionit të ankesave është përfundimtar në procedurë administrative.

Vendimi i dërgohet parashtruesit të ankesës dhe Komisionit vlerësues.

Komisioni i ankesave mban procesverbal për të gjithë procesin e trajtimit të ankesave dhe vendimarrjes.

Komisioni ka mandat 2 vjeçar.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës ndërsa me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

INr. 020/04-51302
Lipjan, më 11.09.2023

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 13 të Rregullores për ndarjen subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, nenit 1 të Rregullores 15Nr.011-15426 të datës 17.03.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, Vendimit të Kuvendit të Komunës për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.400/01-16372 të datës 31.03.2023 si dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023, Kryetari i Komunës nxjerr:

VENDIM

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR SUBVENCIONIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **9,800.00€**, (nëntë mijë e tetëqind euro) Bashkësisë Islame dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400/01-47938 e datës 01.09.2023, për subvencionimin e shërbimeve të varrimit për 35 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur në muajin gusht të vitit 2023 me nga 280 euro për secilin rast $35 \times 280 = 9,800.00€$, të cilat shërbime kryhen nëpërmjet BI - dega në Lipjan në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2023, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryeatrit të Komunës në xhironlogarinë bankare të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan nr.1719200019037882 në NLB.

Neni 3

Obligimet e Këshillit të Bashkësisë Islame rreth kryerjes së shërbimeve të varrimit, afatet e raportimit, dokumentacioni dhe çështje tjera që ndërlidhen me obligimet e ndërsjella mes palëve janë të përcaktuara me dispozitat e Marrëveshjes së cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Këshilli i Bashkësisë Islame i Kosovës dega në Lipjan.

1Nr.400/01-47938
Lipjan, më 04.09.2023

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 9 të Rregullores MF – NR.02/2013 – për menaxhimin e pasurisë jofinanciare në organizatat buxhetore, Rekomandimit të Komisionit të datës 22.09.2023 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr. 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr

VENDIM PËR SHITJEN E BAGËTIVE

Neni 1

Me këtë Vendim në procedurë të ankandit publik sipas Rekomandimit të Komisionit për caktimin e çmimit fillestar për shitjen e bagëtive të ekonomisë bujqësore në SHMP "Adem Gllavica" në Lipjan të datës 22.09.2023, do të bëhet shitja e bagëtive të cilat gjenden në ekonominë bujqësore në SHMP "Adem Gllavica" sipas tabelës në vijim:

Nr.	Emërtimi	Numri i bagëtive	Gjinia	Nr identifikues	çmimi për kg	çmimi për copë
1.	Dele	24 (cope)	/	Pa numër	/	85 €
2.	Gjedha	2 (cope)	Femër	Pa numër	2.10 €	/
3.	Viq	1 (cope)	femër	Pa numër	3.00 €	/
4.	Viq	1 (cope)	mashkull	Pa numër	3.2 €	/

Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Arsim dhe Drejtorati për Prokurim.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Arsim.

1Nr. 053/09-54900
Lipjan, më 25.09.2023

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
SKUPŠTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të neneve 13, 17 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 28 të Ligjit për Inspektoratin Sanitar të Kosovës Nr. 2003/22 si dhe nenit 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit Nr.110/78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr:

V E N D I M
PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E KUSHTEVE SANITARO
- TEKNIKE

I. Me këtë Vendim themelohet Komisioni për shqyrtimin e kushteve sanitaro- teknike në përbërje si vijon:

1. Avni Sahiti, Drejtorati për Inspeksion, kryesues
2. Enis Gashi, Drejtorati për Inspeksion, anëtar
3. Ismet Jashanica, Drejtorati për Inspeksion, anëtar

II. Detyrat themelore dhe përgjegjësitë e Komisionit

Në procedurën e dhënies së lejeve ndërtimore për ndërtimin e objekteve ndërtimore, Komisioni i themeluar shqyrton dokumentacionin teknik dhe jep pëlqimin për harmonizimin e projektit kryesor me kushtet sanitaro – teknike të ndërtimit.

Dokumentacioni për pëlqimet sanitaro – teknike bëhet për projektet kryesore të objekteve të kategorisë së II-të.

Komisioni i themeluar, bënë shqyrtimin e dokumentacionit për dhënien e pëlqimit brenda tetë (8) ditësh pas pranimit të dokumentacionit për shqyrtim. Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, e dorëzon me kohë dokumentacionin teknik te Komisioni, duke pasur parasysh që Komisioni të kryej detyrat e caktuara brenda afatit ligjor për dhënien e përgjigjes për leje ndërtimore.

Në rastet kur dokumentacioni i shqyrtuar ka nevojë të plotësohet apo ndryshohet, atëherë Komisioni përmes Drejtoratit për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit kërkon nga parashtruesi i lëndës që brenda pesë (5) ditësh të bëjë përmirësimet e caktuara.

III. Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit dhe zbatohet deri në një Vendim tjetër.

IV. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi për themelimin e Komisionit për shqyrtimin e kushteve sanitaro teknike 01.Nr.020/04-18098 i datës 06.04.2022 dhe Vendimi për themelimin e Komisionit për shqyrtimin e kushteve sanitaro teknike Nr.01-020/01-46082 i datës 25.08.2023.

A r s y e t i m

Në bazë të dispozitave të Ligjit Nr. 2003/22 për Inspektoratin Sanitar të Kosovës, është përcaktuar marrja e pëlqimit sanitar para dhënies së lejes ndërtimore. Meqenëse nga fillimi i vitit 2022 inspektorët sanitar komunal kanë kaluar në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, vendet e inspektorëve sanitar komunal kanë mbetur të pa mbuluara dhe si rrjedhojë e kësaj çështjet për pëlqime sanitare lidhur me projektin kryesor nuk mund të shqyrtohen.

Për sqarimin e kësaj çështjeje, me datën 25.03.2022 i kemi drejtuar një shkresë Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë dhe të njejtën ditë kemi pranuar përgjigjen nga Agjencia se nga ana e tyre nuk mund të ofrohet ndonjë zgjidhje.

Prandaj, të ndodhur në këtë situatë të krijuar, si dhe duke pasur parasysh detyrimet e përcaktuara me nenin 17 dhe 21 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtimin, u vendos të themelohet Komisioni për shqyrtimin e kushteve sanitaro – teknike të projekteve kryesore, ashtu edhe siç është përcaktuar në dispozitivin e këtij Vendimi.

Me këtë Vendim njoftohen:

Të emëruarit në Komisionin e caktuar;
DPUMM

Nr. 01-020/04-50561
Lipjan, më 07-092023

Imri AHMETI

Kryetar Komunes





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, nenit 10 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019 ,Vendimit të Kuvendit të Komunës për ndarjen e mjeteve financiare 15Nr.400/01-39095 i datës 28.07.2023 për ndarjen e mjeteve financiare kompanisë rajonale të mbeturinave "Pastrimi" SH.A, duke u bazuar edhe në kërkesën e KRM " Pastrimi të datës 17.07.2023, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë

VENDIM PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE

Neni 1

1. Me këtë Vendim, i TRANSFEROHET, shuma e mjeteve në vlerë prej prej 25,000.00 € (njëzet e pesë mijë) euro, Kompanisë Rajonale të Mbeturinave "Pastrimi" SH.A, konform Vendimit të Kuvendit të Komunës për ndarjen e mjeteve financiare 15Nr.400/01-39095 i datës 28.07.2023 dhe kërkesës së KRM " Pastrimi të datës 17.07.2023.

2. Shuma e cekur në paragrafin 1 të këtij neni ndahet me qëllim të për subvencionimit të familjeve në asistencë sociale të Komunës së Lipjanit për pagesën e borgjeve përkatësisht kryerjen e pjesërishme të obligimeve të grumbullura deri me datën 31.10.2022, që familjet në asistencë sociale kanë ndaj KRM "Pastrimi" për ofrimin e shërbimeve për marjen e mbeturinave

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2023, pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës në xhirollogarinë bankare nr.1700200100051292 në NLB të KRM Pastrimi-SHA.

Neni 3

Lidhur me mjetet e shpenzuara , KRM Pastrimi duhet të sjellë raport financiar duke bashkëngjitur listen e familjeve në asistencë sociale të subvencionuara dhe të njëjtat t'i dorëzojë në Zyrën e Kryetarit të Komunës- Sektorin për përfaqësim dhe çështje ligjore brenda afatit 45 (katërdhjetë e pesë) ditor nga dita e ekzekutimit të pagesës.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe KRM "Pastrimi".

1Nr. 01-400/01-36373
Lipjan, më 14.09.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Ligjit për menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë nr.03/L-048, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, konform edhe dispozitave të Marrëveshjes për Bashkëpunim të lidhur në mes të Komunës së Lipjanit përfaqësuar nga Z. Imri Ahmeti dhe OJQ-së Ndërkombëtare Caritasit Switzerland (në Kosovë) me përfaqësues ligjor Z. Gerhard Schaumberger 1Nr-660/03-6458 të datës 06.02.2023, duke u bazuar edhe në kërkesën e Drejtorit të DKA-së dërguar përmes emailit zyrtar me datë 20.09.2023, Kryetari i Komunes, nxjerr

VENDIM PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE

Neni 1

1.Me këtë Vendim, **TRANSFEROHET**, shuma e mjeteve në vlerë prej **1320.00 €** (një mijë e treqind e njëzet euro) , për zbatimin e obligimeve që rrjedhin nga dispozitat e nenit 4 të Marrëveshjes për Bashkëpunim të lidhur në mes të Komunës së Lipjanit përfaqësuar nga Z. Imri Ahmeti dhe OJQ-së Ndërkombëtare Caritasit Switzerland (në Kosovë) me përfaqësues ligjor Z. Gerhard Schaumberger 1Nr-660/03-6458 të datës 06.02.2023. me titull të Projektit : Ndikimi i Rinisë në Mjedis –YENI (P220002).

2. Shuma e cekur në paragrafin 1 të këtij neni destinohet për kryerjen e obligimeve të pagesës për tri shkollat e mesme të Komunës së Lipjanit si vijon:

- 2.1 SHML Gjimnazi "Ulpiana" në Lipjan 440 € (katërqind e katërdhjetë euro)
- 2.2 SHMP " Adem Gllavica" në Lipjan 440 € (katërqind e katërdhjetë euro)
- 2.3 SHMLM " Shaqir Hoxha" në Shalë 440 € (katërqind e katërdhjetë euro)

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga kategoria ekonomike –mallra dhe shërbime të Drejtoratit për Arsim në xhironlogarinë bankare :

Banka: Raiffeisen Bank

Emri: CARITAS SWITZERLAND

IBAN: XK051502001000368642

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë ndërsa për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorati për Arsim.

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi për transferimin e mjeteve financiare 1Nr.400/01-32319 i datës 22.06.2023.

1Nr. 400/01-54291
Lipjan, më 21.09.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

